

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

01.06.2022
Ora 10:32

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zotit Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, zotit Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i Bashkisë Shkodër dhe Partisë Demokratike, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PD (z. Marash Logu)**
- **Të tjerë:**
 1. Qëndresa Qytetare: **Z. Rigels Xhemollari, znj. Teisa Kurti**
 2. **KRIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, fillojmë seancën publike për shqyrtimin e çështjeve si vijon: kemi projektvendimin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë;

Kemi shpalljen e vendimit pas shqyrtimit të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kandidatit për Kryetar Bashkie Rrogzhinë, Ministrin të Shtetit për Rindërtimin dhe deputetin të Partisë Socialiste zotit Etjen Xhafaj;

Pika e tretë, ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zotit Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, zotit Xhemal Bushati, kandidat për kryetar i Bashkisë Shkodër nga Partia Demokratike, për shkelje

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022;

Pika e katërt, shqyrtimi i denoncimit, po të organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zonjës Eriselda Sefa, kandidate për kryetare të Bashkisë Lushnje, zotit Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile si dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022;

Pika e pestë, shqyrtimi i denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zonjës Majlinda Angoni, kandidate për kryetar të Bashkisë Shkodër, zotit Haki Çako, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, po për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022;

Pika e fundit shqyrtimi i denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zonjës Majlinda Angoni, kandidate për kryetare të Bashkisë Shkodër, qendrës shëndetësore Rrethina, ambulanca Dobraç, zonjës Edona Tafa dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.


Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për procedurë zoti Komisioner!

Z. I. Celibashi: Po zoti Marash!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Komisioner, do të kërkoja nga ana juaj me mirëkuptim, duke qenë dhe për shkakun se kjo mbledhje u shty pak jashtë orarit, si pikë e parë e rendit të ditës të ishte, shqyrtimi i denoncimit të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zotit Fatmir Juka, zotit Xhemal Bushati dhe Partisë Demokratike. Më pas të vijoni me pikat e tjera të rendit të ditës, për të cilat besoj nuk do të jetë e nevojshme që të ketë prezencë nga ana jonë si subjekt politik, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! Atëherë, shqyrtojmë si pikë të parë të rendit të ditës denoncimin e Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zotit Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, zotit Xhemal Bushati, kandidat për kryetar i Bashkisë Shkodër nga Partia Demokratike. Hapim seancën për shqyrtim. Prezent përfaqësuesit e Organizatës Qëndresa Qytetare, faleminderit për prezencën! Përfaqësues të zotit Fatmir Juka? Nuk ka! Nga galeria? Nuk ka! E keni bërë njoftimin? Dakord! Për zotin Xhemal Bushati, do ta përfaqësoni ju? Atëherë, kandidati i Partisë Demokratike për kryetar të Bashkisë Shkodër, në zgjedhjet e 6 Marsit 2022 do të përfaqësohet nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike në KQZ, zoti Marash Logu! I japim fjalën përfaqësuesve të Qëndresës për të prezantuar pretendimet e tyre në lidhje me këtë denoncim, faleminderit!

Znj. T. Kurti: Faleminderit i nderuar! Qëndresa Qytetare me denoncimin me nr. 3691 ID ka denoncuar aktivitetin e datës 23.02.2022 të kandidatit për kryetar bashkie të Partisë Demokratike, zotit Xhemal Bushati i cili ka vizituar Galerinë e Arteve në Shkodër. Në vijim të shkresave që na janë përcjellë dhe të përgjigjeve që jemi njohur: Së pari, ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore në referim të Vendimit nr. 2 pika 2 i Komisionit Rregullator. Kohë e cila kërkon kujdes të shtuar nga ana e institucioneve publike në pjesëmarrjen e tyre në aktivitete me karakter publik dhe jo vetëm. Në referim të Kodit Zgjedhor, neni 91, parashikon në mënyre eksplicite se nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje, burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor. Me “burime” nuk përkufizohen vetëm burimet fizike, por dhe burimet njerëzore të institucioneve. Përdorimi ose vënia në mbështetje të kandidatëve, subjekteve zgjedhore, e burimeve të organeve apo enteve publike favorizon këtë të fundit duke dëmtuar procesin demokratik të zgjedhjeve dhe konkurrencën e lirë dhe të pastër.

Së dyti, zoti Juka në shkresën e tij pretendon se nuk ka patur dijeni për vizitën e kandidatit Bushati dhe e ka konsideruar si një qytetar të zakonshëm, por kjo kundërshtohet nga provat dhe faktet e administruara për këtë denoncim. Ky takim është publikuar edhe në median lokale “Star Plus Tv” ku shihet se zoti Juka shoqëron kandidatin dhe pozon para kamerave i pa shqetësuar edhe pse pas marrjes dijeni se zoti Bushati ndodhej në Galerinë e Arteve për qëllime elektorale. Rrjedhimisht, ai kishte detyrimin ta ndalonte aktivitetin dhe të mos e shoqëronte kandidatin në daljen publike.

Së treti, në referim të nenit 6 pika 3, “Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohej çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik..”, siç është edhe ky aktivitet i zotit Bushati i cili gjendej në Galerinë e Arteve vetëm në kuadër të premtimeve elektorale që ai ka dhënë. Po ashtu, për sa i përket raportimit, nga kërkimet në faqen zyrtare ky aktivitet nuk rezulton të jetë i raportuar. Në konkluzion, pasi jemi njohur me përgjigjet e zotit Fatmir Juka, ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë fakt apo provë të ligjshme e cila vërteton se në këtë aktivitet publik nuk janë përdorur burime të organeve apo enteve publike dhe palët e denoncuara nuk janë në shkelje të nenit 92. Zoti Xhemal Bushati, sic shihet qartë nga provat e paraqitura, ka kryer një takim elektorale në ambientet e Galerisë së Arteve Shkodër, duke shkelur kështu parashikimet e Kodit Zgjedhor. Provë për këtë janë edhe fotot e videot e postuara

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022**

nga palët, por edhe nga televizioni lokal. Për sa më sipër, kërkojmë: konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e masave administrative bazuar në nenin 171 dhe 172 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 10 të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, ndaj Drejtorit të Galerisë së Arteve zotit Fatmir Juka, ndaj subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë dhe kandidatit zotit Xhemal Bushati, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, i japim fjalën zotit Marash Logu, si përfaqësues i kandidatit, por në mirëbesim, do të sillni dhe autorizimin përkatës.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dhe i subjektit të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Z. I. Celibashi: Ju keni të drejtë të flisni dhe si përfaqësues i Partisë Demokratike, pa diskutim, por meqenëse kërkuat të përfaqësoni edhe kandidatin, në këtë cilësi dhe mund të flisni, por duhet të sillni një autorizim, në mirëbesim po për procedurë duhet!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Patjetër!

Z. I. Celibashi: Mirë vazhdojmë, fjala është për ju!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Komisioner! Së pari sinqerisht dëshiroj të përgëzoj Organizatën Qëndresa Qytetare, për një punë të bërë qoftë gjatë zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit 2021, por edhe gjatë zgjedhjeve të pjesshme vendore të 6 Marsit 2022, në monitorimin e veprimtarisë së institucioneve publike,


**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

partive politike dhe kandidatëve të tyre në zgjedhje. Sigurisht që në vitin 2020 kur u bënë ndryshimet në Kodin Zgjedhor, subjektet politike, apo partitë politike kishin parasysh faktin që mundësitë e institucioneve publike, por dhe të partive për të monitoruar, apo mbikqyrur veprimtarinë e institucioneve, kandidatëve, apo të partive politike ishin të kufizuar. Në këtë kuptim organizatat e shoqërisë civile, pra organizatat jo fitimprurëse kishin dhe kanë një rol thelbësor. Rol që si përfaqësues i subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, sigurisht që e vlerësojmë. Ky vlerësim është i dyfishtë për Qëndresën Qytetare, ndoshta është për ta thënë. Unë kam pas mundësi para se të angazhohesha në politikë, të jem dhe vetë një nga njerëzit që jam angazhuar si këshilltar ligjor pranë Qëndresës Qytetare. Në këtë kuptim shoh me kënaqësi një aktivitet të shtuar për sa i përket garantimit të standarteve të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Thënë këtë zoti Komisioner, e vërteta është që mendoj se në rastin konkret, miqtë e mi të Qëndresës Qytetare gabohen në interpretimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, ashtu siç gabohen edhe në interpretimin e ligjit. Së pari, zoti Xhemal Bushati nuk është një kandidat i importuar nga ndonjë qytet tjetër. Është një qytetar që vjen nga një familje e madhe shkodrane, familja e Bushatllinjëve, të cilët besoj e dini që të gjithë e njohin për shkak të njohurive në histori. Është një qytetar që ka jetuar gjithë jetën e tij në Shkodër me një sipërmarrje dhe aktivitet të suksesshëm në botën e biznesit. Nga viti 2007 deri në vitin 2019 ka qenë anëtar i Këshillit Bashkiak Shkodër. Nga viti 2015 deri në 2019 ka qenë dhe kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër. Sigurisht për shkak të aktivitetit të tij, për shkak të sipërmarrjeve të tij, por dhe për shkak të funksioneve që ai ka mbajtur në administratën vendore të Bashkisë Shkodër ka lidhjet, njohjet, kontaktet e tij me qytetarët e tjerë të nderuar të qytetit të Shkodrës. Gjithashtu dhe me përfaqësues të institucioneve publike siç besoj është dhe rasti i zotit Juka, i cili me aq sa unë kam informacion është po ashtu një njeri i nderuar që kryen me


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

devotshmëri punën e tij si drejtor i Galerisë së Arteve në Shkodër. Tani pse nuk ka shkelje, zoti Komisioner në këtë lloj çështjeje. E para, miqtë e mi të Qëndresës Qytetare, ndoshta nuk e dijnë, që Galeria e Arteve është një institucion publik që ka varësi nga Ministria e Kulturës. Ministria e Kulturës nga e cila emërohet edhe zoti Juka, besoj se askush nuk ka dyshimin për drejtimin politik të kësaj ministrie. Pra, afër mendsh do të ishte shumë e çuditshme në fakt, surprizuese që një drejtues institucioni që është në varësi të Ministrisë së Kulturës, që drejtohet nga një përfaqësuese e lartë e Partisë Socialiste, të vihet ai vetë, apo të verë institucionin e tij në mbështetje të kandidatit të Partisë Demokratike. Nuk besoj se ka pasur ndonjë herë rast të ngjashëm. Do të ishte e kuptueshme në fakt, në qoftë se ky institucion do të ishte në varësi të Bashkisë Shkodër. Por në rastin specifik edhe në Bashkinë Shkodër patëm një situatë ku kryetarja e bashkisë mbështeste kandidatin e Shtëpisë së Lirisë, kjo publikisht. Pra, zoti Xhemal Bushati nga pikëpamja institucionale, qoftë të institucioneve vendore, qoftë atyre qendrore, nuk ka pas asnjë lloj mbështetje, të hapur, të fshehtë, të nënkuptuar dhe aq më pak që të viheshin institucione, apo drejtues të tyre në dispozicionin e tij. Galeria e Arteve, zoti Komisioner nuk është si shkolla, nuk është si spitali, nuk është si institucionet e tjera që ti shkon se ke një punë të posaçme. Psh, çfarë do një kandidat i një partie politike në një shkollë? Shkon vetëm në qoftë se ka një aktivitet politik për të zhvilluar, për të takuar prindër, nxënës dhe do ta organizojë aty. Galeria e Arteve është një institucion i cili jam i bindur zoti Komisioner, që dhe nesër e pasnesër po të shkojmë bashkë, unë me ju, apo miqtë e mi të Qëndresës Qytetare, mund të shkojmë ta vizitojmë. Me shumë mundësi për shkak se institucioni është shumë i vogël do të takojmë dhe drejtorin e kësaj galerie, i cili në kuadër të funksionit, siç e ka shprehur dhe në shkresën e tij, kryen: pritje, informon qytetarët, përcjellje. Pra, nuk ka pasur qartazi, drejtori i Galerisë së Arteve, asnjë lloj qëllimi që t'i verë në dispozicion një


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

kandidati të një partie politike kundërshtare me atë që në fakt e ka emëruar atë në detyrë. T'i verë në dispozicion institucionin që ai drejtonte dhe aq më tepër të vihet ai vetë në mbështetje të kandidatit të Partisë Demokratike. Në këtë kuptim situata është e qartë. Ai ka pritur një qytetar, e thashë dhe pak më parë, zoti Xhemal Bushati, sigurisht që nuk është një njeri anonim i pa njohur, që të mos meritonte gjithë respektin dhe kortezinë e një drejtuesi institucioni. Ai e ka pritur, e ka informuar, e ka shoqëruar dhe më pas e ka përcjellë. Nuk ka në gojën e drejtorit të Galerisë së Arteve, asnjë fjalë, asnjë shprehje, asnjë gjest që të shprehë çfarëdo mbështetje, suporti, apo thirrje për kandidatin e Partisë Demokratike. Nga ana e tij zoti Bushati, është e vërtetë, ka qenë në një vizitë në Galerinë e Arteve Shkodër. Sigurisht që, zoti Komisioner, në fushatë zgjedhore, çfarëdo që ti të bësh, edhe kur ulesh të konsumosh një sanduiç, në qoftë se ka kamera dhe fotografë afër, mund të konsiderohet si një lloj veprimtarie elektorale. Por, nuk besoj se ne do të vrapojmë t'i kërkojmë llogari pronarit të fast food-it, cila është arsyeja që ti lejon, etj., etj., në qoftë se do të kishte ndonjë lloj detyrimi. Pra, zoti Bushati edhe po të shihni gjuhën e tij në fakt që është cituar i referohet një projekti që s'ka të bëjë fare me Galerinë e Arteve. Ka një gjuhë krejtësisht të zhveshur nga diskutimi politik. Një vizitë krejtësisht normale, në një institucion publik, nuk ka zhvilluar takim. Unë do ta kuptoja, në qoftë se zoti Bushati në ambjentet e Galerisë së Arteve do të kishte nja 20-30 qytetarë, njerëz të interesuar për artin e kulturën të cilët ai do t'i takonte, t'u bënte premtime t'i informonte etj., etj. Ngjyra të tilla nuk ka pasur. Në këtë rastin konkret, zoti Komisioner, nuk jemi as në shkelje të zotit Juka, sepse paska vënë në dispozicion të tij ambiente, apo asetë publike, aq më tepër që ai vetë të jetë vënë në dispozicion. Nga ana tjetër, këtu nuk u tha, ndoshta është mirë të thuhet, sepse kur bëhet një denoncim është mirë të identifikohet përgjegjësia e gjithsecilit. Pra, cila është shkelja konkrete, cila pikë, cila gërmë? Cili nen, i cilit ligj është shkelur nga zoti Bushati dhe nga subjekti politik

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

Partia Demokratike e Shqipërisë? Në mënyrë që më pas edhe ne të mund të japim përgjigje. Megjithatë për ta përmbyllur zoti Komisioner, unë mendoj se në rastin konkret, as zoti Juka, as zoti Bushati dhe as subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë nuk kanë kryer asnjë lloj shkelje të Kodit Zgjedhor, e aq më pak të një akti nënligjor të KQZ-së. Në një shtet ku pothuajse të gjitha pushtetet janë në dorë të një subjekti politik, vështirë të mendojmë tani që një pjesë e këtyre strukturave vihen në dispozicion të kandidatëve kundërshtarë, siç ka qenë rasti i zotit Bushati, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Logu! Keni diçka për të shtuar, ose për të replikuar në lidhje me atë çfarë u prezantua?! Po!

Znj. T. Kurti: Po i nderuar! Për sa i përket gjithë retorikës që zoti Logu mbajti, m'u duk shumë abstrakte dhe subjektive, sepse nuk solli asnjë fakt konkret, por thjesht foli për lidhje familjare etj., që nuk janë as objekt gjykimi i këtij procesi hetimor, por as të frutshme për këtë proces hetimor. Zoti Logu pranoi që Galeria e Arteve është një institucion publik dhe pyetja ime retorike është që, pse ky institucion publik duhet të bëjë përjashtim nga neni 92 që ndalon përdorimin e burimeve publike në fushatë elektorale për aktivitetet me karakter elektoral? Pra, në gjykimin tonë, kjo është një shkelje e hapur e nenit 92 nga ana e drejtorit të Galerisë së Arteve, e kandidatit dhe e subjektit. Zoti Logu tha që drejtori e ka pritur në mënyrë qytetare, siç do të priste çdo qytetar tjetër. Ama institucionet publike gjatë kohës së fushatës zgjedhore kanë detyrimin të tregojnë një kujdes të shtuar dhe të distancohen ndaj çdo aktiviteti elektoral që zhvillohet gjatë orarir zyrtar të punës. Po ashtu, provë për këtë është fakti që zoti Bushati ka publikuar foto me logon e Partisë Demokratike të drejtorit. Gjë që drejtori, besoj nuk duhet të kishte lejuar foto me elementë elektoralë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

Gjithashtu shihet që ai pozon shumë i lumtur, i pashqetësuar pranë kandidatit. Këto dhe të gjitha faktet provojnë që jemi në shkelje të hapur të nenit 92 dhe zoti Logu gjithashtu kërkoi se në cilat dispozita referohemi. Në bazë të nenit 171 të Kodit Zgjedhor, drejtori ka detyrimin si një person i ngarkuar me detyra nga ky kod, të ndalonte aktivitetin dhe të distancohej. Ndërsa kandidati si subjekt zgjedhor, por edhe Partia Demokratike në bazë të nenit 172 të Kodit Zgjedhor, nuk duhet të zhvillojnë aktivitetin elektorale.

Z. I. Celibashi: Po zoti Logu, ju lutem shkurt!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Komisioner e para besoj, kur unë jam në këtë sallë, ju jeni drejtues i një institucioni publik dhe nuk mund të mbani përgjegjësinë se çfarë them unë. Në qoftë se unë në një moment filloj dhe bëj propagandë politike, nuk është se ju në këtë sallë, ngriheni dhe më mbyllni gojën, etj., etj. Minimalisht do të më lejoni që unë të përfundoj, ndoshta duke mos përkrahur as deklaratat e mia, as qëndrimet e mia. Është gati absurde të thuash që meqenëse zoti Bushati paska postuar në facebook-un e tij një foto me logon e Partisë Demokratike të dikujt, ai person paska qenë në mbështetje të tij, ky do të ishte abuzim total. Ka shumë foto dhe shumë gjëra që postohen në rrjetet sociale, për të cilat njerëzit nuk është se kanë ndonjë qëndrim. Pra, qartazi, zoti Juka, as ka bërë asnjë deklaratë, as një shprehje në mbështetje të kandidatit të Partisë Demokratike. Nga ana tjetër, e thashë zoti Komisioner, kjo ka qenë një vizitë krejtësisht normale që kryhet në një ambjent që pret informon dhe përcjell qytetarë. Nuk jemi në rastin e një institucioni të mbyllur ndaj njerëzve dhe qytetarëve, që as kandidatë, as qytetarë, as njerëz të tjerë nuk kanë se çfarë të bëjnë në një mjedis të tillë. Nuk kemi aktivitet.. se këtu do të na duhet të ndajmë se çfarë është aktivitet, takim elektorale etj., etj. Me sa kuptoj unë, aty zoti


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

Bushati nuk është se ka thirrur njerëz, ka takuar qytetarë, ka pas me vehte banderola, flamuj. Po të shihni veshjen e zotit Bushati nuk ka as simbole partiake, as deklarata që janë cituar, nuk është përmendur as numëri i tij, as fakti që ai kandidonte, as që “votoni Partinë Demokratike”. Pra, çfarëdo thënie të natyrës politike. Ky takim, zoti Komisioner, sigurisht që është në një kohë të fushatës zgjedhore, është fakt. Zoti Xhemal Bushati ishte kandidat i Partisë Demokratike, edhe ky është fakt. Nga ana tjetër, as zoti Juka, as zoti Bushati, as Partia Demokratike e Shqipërisë, as nuk kanë përdorur institucione publike për të bërë aktivitete të natyrës elektorale politike dhe aq më pak që punonjësve të këtij institucioni t’u jetë kërkuar nga ana jonë, apo të jenë ofruar ata nga ana e tyre që të vihen në mbështetje të kandidatit të Partisë Demokratike. Arësyet i thashë dhe më parë, janë të qarta. E para, sepse unë besoj se ata janë njerëz të ndërgjegjshëm që zbatojnë ligjin. E dyta, që është më e rëndësishmja që bën sens logjik, është fakti që ky është një institucion që drejtimin politik e ka Partia Socialiste. Nuk besoj që zonja Kumbaro, të lejojë që një drejtor në Shkodër, apo në Kukës, apo në Tiranë të vihej në mbështetje të kandidatëve të Partisë Demokratike. Ajo parimisht nuk duhet të lejojë të vihen në mbështetje edhe të kandidatëve të Partisë Socialiste, po në mbështetje të kandidatëve të Partisë Demokratike, besoj se kjo do të ishte tërësisht e palejuar dhe ndaj tij do të ishin marrë masa, gjë që deri tani nuk ka rezultuar. Më duket një sqarim plotësisht logjik, qytetar shpjegimet që ka sjellë zoti Juka ku thotë “nuk kam” dhe në fakt nuk ka pasur ta konfirmoj, nuk ka pasur njoftim paraprak, që zoti Bushati t’i thoshte atij që “unë do të vij në këtë orar, do të kem nj, dy, tre, katër aktivitete, do të bëj këtë, do të bëj atë”. Ai ka qenë një takim, ka shkuar, është pritur, është përcjellë, është informuar, është larguar në punën e tij dhe zoti Bushati ka vazhduar me takimet elektorale. Në qoftë se doni, mund të sjell dhe zonat në të cilat ka qenë duke zhvilluar takimet elektorale. Ato kanë qenë aktivitete politike, ato kanë qenë aktivitete elektorale. Duhet të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*


ndalem zoti Komisioner, se ndoshta kolegët për shkak të një eksperiencë më të vogël në këtë fushë, që qëllimi i legjislatorit në fakt ka qenë që institucionet publike, të cilat kanë një lloj caktimi të drejtuar politik, të mos vihen në mbështetje të kandidatëve të partive të tyre, besoj. Pra, në qoftë se bashkia drejtohet nga partia “x” në zgjedhje, e gjithë bashkia, të gjithë punonjësit, e gjithë administrata të mos vihet në mbështetje të kandidatit të partisë së tij. Ashtu si dhe institucionet qendrore të mos vihen në mbështetje të partisë së tyre. Por, kur institucioni qendror, apo bashkia, institucionet lokale drejtohen nga një parti “x” dhe kandidati është i partisë “y”, besoj se kjo nuk do mend, të gjithë e kuptojnë që institucioni “x”, nuk vihet në dispozicion të këtij kandidati. Kjo është situata, do të ishte alogjike që të thonim që Galeria e Arteve në qytetin e Shkodrës, qenka vënë në dispozicion të kandidatit të Partisë Demokratike, ndërkohë që për të gjithë është e qartë se kush ka drejtimin politik të këtij institucioni, por po të doni dhe të ministrisë në varësi të të cilës është ky institucion.

Z. I. Celibashi: E fundit dhe shkurt ju lutem!

Znj. T. Kurti: Do të doja të ndalesha pak tek elementët elektorale që zoti Logu tha. Një pyetje për zotin Logu. Në qoftë se Partia Socialiste do të përdorte një foto tënden me logon e Partisë Socialiste, ju do ta lejonit?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nuk mund ta ndaloj. Në qoftë se Partia Socialiste nesër, pasnesër poston një foton time, madje Partia Socialiste ka përdorur video të miat në këtë funksion dhe i ka vënë në funksion të propagandës së saj. Unë mund të kisha shkuar në gjykatë, mund të kisha bërë procese të tjera, por s’mund... unë nuk mund të vendos, vetëgjyqësia është krim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

Znj. T. Kurti: Pra ju keni një mjet që mund ta ndaloni? Shkoni në gjykatë?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, në qoftë se unë mendoj se më cënon! Unë nuk mendoj se më cënon Partia Socialiste. Zoti Juka nuk ka menduar se e ka cënuar, po nuk është zoti Juka, e as unë përgjegjës se çfarë postojnë njerëzit në rrjetet sociale. Zoti Komisioner psh rregullisht në facebook-un e tij poston foto të këtyre seancave, më nxjerr edhe mua, është në të drejtën e tij. Në qoftë se unë do të kisha ndonjë shqetësim do t'ia adresoja, por deri më tani nuk kam pas ndonjë shqetësim.

Znj. T. Kurti: Gjithashtu zoti Logu tha që “nuk kishte njerëz të tjerë”, por zoti Bushati në atë galeri ka pozuar me persona të tjerë të paidentifikuar që janë një grup i konsiderueshëm njerëzish.


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë tek i njejtë argument dhe mendoj që.. në qoftë se keni diçka tjetër për të shtuar, por mendoj se është e qartë mbi ç'bazë ju...

Z. R. Xhemollari: Në qoftë se mund ta përmbyll atë që u tha?

Z. I. Celibashi: Po!

Z. R. Xhemollari: Sigurisht që unë e vlerësoj zotin Logu për vlerësimin ndaj Qëndresës dhe për pasionin e tij që ka për të mbrojtur Partinë Demokratike. Koha kur ne i gjykonim njerëzit nga biografia, apo nga gjeografia ka përfunduar në vitin 90. Pra, sa burrë i ndershëm e sa burrë i mirë ka qenë zoti Bushati, kjo është tjetër çështje. Ne gjithashtu nuk e shohim ligjin me ngjyra, nuk e shohim as blu, as rozë. Pra, ne e lexojmë ligjin ashtu siç është. Se kujt i shërben, se kush e drejton asetin,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*

kjo është një çështje tjetër. Ne shohim zbatohet ligji, apo jo! Në këtë rast, ne shohim që zoti Bushati, brenda Galerisë së Arteve ka thënë “unë e kam një projekt për ta zbatuar, që kurrë nuk gjeti vullnetin e të tjerëve. Në fakt e kam kërkuar që kur isha kryetar i këshillit bashkiak. Ta kthejmë ndërtesën në të cilën sot ndodhet këshilli i qarkut, në një muze. Në një shtëpi më shumë për artin”. Pra, brenda Galerisë së Arteve ka bërë një premtim për artin, në një aset publik, në prani të drejtorit. Mendojmë që shkelja është brenda dhe ne i qëndrojmë gjithë akuzës tonë, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Prova dokumentare, ose të tjera për të provuar pretendimet tuaja? Ato që keni depozituar bashkë me denoncimin, të tjera shtesë nuk keni, ato fotografitë?

Znj. T. Kurti: Fotografitë janë depozituar në denoncimin e parë!

Z. I. Celibashi: Në rregull!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Unë kërkoj që provat të na vihen në dispozicion. Ka një formë se si provat merren dhe administrohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Duhet të jenë me shkresë zyrtare dhe kopje origjinale, ose duhet të jenë të noterizuara. Në qoftë se do të jenë foto që ne nuk e dimë se ku janë marrë e si janë marrë etj., etj., ne kërkojmë që këto të mos pranohen, madje as të mos administrohen si provë. Besoj, nuk dua të zgjatem, se ne jemi profesionistë të kësaj pune, kemi pas eksperiencë në avokati. Në qoftë se një provë nuk është në formën e kërkuar nga ligji, ne kërkojmë që të mos administrohet nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por t’i kërkohet brenda një afati, në qoftë se do të vlerësohet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 01.06.2022*


e nevojshme, që të sillet në formën e kërkuar nga ligji besoj. Në mënyrë që të kemi një proces të rregullt ligjor.

Z. I. Celibashi: Atëherë, do të procedojmë kështu: ne do t'ju vemë në dispozicion çfarë organizata ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Do të merrni kohën e mjaftueshme për të bërë një vlerësim të tyre për të bërë prezantimin tuaj në lidhje me secilën prej atyre provave të themi që ka prezantuar organizata. Jemi dakord?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë! Do ta përfundojmë këtu seancën për këtë çështje dhe do të vazhdojmë një ditë tjetër. Data dhe ora do të njoftohet zyrtarisht, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

01.06.2022
Ora 11:04

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Olta Luan Zylyftari”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, znj. M. Koja, znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka!**
- **Të tjerë:**
 1. Qëndresa Qytetare: **Z. Rigels Xhemollari, znj. Teisa Kurti**
 2. **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës. Kemi projektvendimin për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë.

Z. Y. Merkaç: Këshilli i Bashkisë Korçë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, nga zoti Andrea Jorgaq Shkodrani, propozuar nga Partia Socialiste. Në bazë të nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Korçë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 38, zonja Olta Luan Zylyftari. Kandidati për këshilltar ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 30. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidaten zonjën Olta Luan Zylyftari e cila ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile, në rubrikën mbiemri nga “Islami”, në “Zylyftari”. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Korçë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor si dhe Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Zonja Olat Luan Zylyftari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Korçë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Olta Luan Zylyftari.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr. 170

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

01.06.2022
Ora 11:06

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë zotit Edison Memolla, Zëvendëskryeministrit, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave zotit Arben Ahmetaj dhe deputetit zotit Etjen Xhafaj, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Të tjerë:**
 1. Qëndresa Qytetare: **Z. R. Xhemollari, Znj. Teisa Kurti**
 2. **KRIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shpalljen e vendimit, “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë zotit Edison Memolla, Zëvendëskryeministrit, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave zotit Arben Ahmetaj dhe deputetit zotit Etjen Xhafaj, në lidhje me shkeljet administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

Prezent janë vetëm përfaqësuesit e organizatës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

Në lidhje me këtë shqyrtim administrativ, konkluzioni ynë është se jemi vetëm para shkeljeve administrative të kryera nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë dhe kjo për faktin se ai nuk ka raportuar veprimtarinë publike të cilën ka zhvilluar. Raportimi i kësaj veprimtarie është bërë me shkresë, pra jo në përputhje me të gjitha parashikimet e aktit përkatës të rregullatorit.


Për sa i përket ministrit Ahmetaj dhe deputetit Etjen Xhafaj, vlerësojmë se nuk jemi para shkeljeve administrative, sikurse do të duhej të ishin bazuar në përcaktimet e aktit rregullator. Ky është vendimi!

Kundër këtij vendimi, palët e interesuara mund të bëjnë ankim në KAS brenda tridhjetë ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes së tij dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 171

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

01.06.2022
Ora 11:08

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zonjës Eriselda Sefa kandidate për kryetare të Bashkisë Lushnje, zotit Haki Çako, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ:
**Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Të tjerë:**
 1. Qëndresa Qytetare: **Z. R. Xhemollari, znj. Teisa Kurti**
 2. **KRIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Kemi shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zonjës Eriselda Sefa kandidate për kryetare të Bashkisë Lushnje, zotit Haki Çako, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Përfaqësuesit e Qëndresës janë prezent!

Nga pala tjetër? Nuk kanë ardhur! Kanë marrë dijeni? Ju i keni çuar njoftim? Dakord, atëherë i japim fjalën përfaqësuesit të Qëndresës për të prezantuar pretendimet e tyre në lidhje me këtë denoncim. Po, fjala është për ju!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

Znj. T. Kurti: Faleminderit i nderuar! Në denoncimin me nr. 3606 ID, Qëndresa Qytetare ka denoncuar aktivitetin e datës 20 shkurt 2022 në Fshatin Thanasaj ku në praninë e kandidatës së Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetare të bashkisë zonjës Eriselda Sefa, drejtuesit politik të qarkut zotit Taulant Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, zoti Haki Çako, kanë vizituar punimet dhe investimet mbi Lumin Shkumbin. Investim ky i financuar nga fondi AKMC. Gjithashtu kanë promovuar edhe investime të ardhëshme. Për sa i përket themelit dhe pretendimeve për përdorimin në mbështetje të kandidatit me burime të organeve dhe enteve publike, nga shkresat që jemi njohur, pretendohet se ka qenë një takim rastësor nga zoti Çako. Kjo kundërshtohet nga faktet e administruara dhe nuk rezulton si i tillë. Ky është një takim i organizuar tepër mirë, me një prani të shtuar të banorëve të zonës të cilët jo rastësisht ndodheshin pranë vendit ku po bëheshin punimet duke mos hezitur të takojnë dhe shoqërojnë zyrtarët e lartë, por dhe kandidatin. Natyrshëm lindin pyetjet mbi këto rrethana:

Kush i kishte njoftuar më parë banorët e zonës mbi këtë takim?

Kush ishte organizatori i këtij takimi?

Nëse ishte rastësor përse lindi nevoja e publikimit të çdo detaji të këtij aktiviteti?

E dyta, Çfarë vlen për t'u theksuar është fakti se drejtori i AKMC, është shprehur se ky investim ka qenë një nga 7 projektet e përcjella për financim nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që prej muajit Korrik 2021. Duke u nisur nga ky fakt dhe deklaratimet e Bashkisë Lushnje se nevojitej një ndërhyrje e menjëhershme shihet se nga ana AKMC është dashur një afat prej rreth pesë muajsh, për shpalljen e njoftimit të tenderit dhe shpalljen e fituesit, që rastësisht përkon me fushatën zgjedhore. Sipas shkresës së zotit Çako, thuhet se për këtë tender është përdorur "Procedura e Hapur" që sipas ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", neni 42 parashikon se "për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

monetar afat i pranimit të ofertave është jo më pak se 20 ditë”. Pra, kësaj agjencie i është dashur pesë muaj të tenderonte këtë investim publik, kur ndërkohë për procedurën që është përdorur mjaftonin vetëm 20 ditë. Gjithashtu nga shkresa e Bashkisë Lushnje, informohemi se kompania është kontraktuar nga AKMC në datë 22.12.2021 dhe është pajisur me lejen e ndërtimit në datë 18.01.2022, datë me të cilën ishim njohur dhe me datën e zgjedhjeve lokale. Jemi në kushtet kur janë vënë në dispozicion fonde vetëm dy muaj para datës së zgjedhjeve vendore të datës 6 Mars. Këtu ndodhemi para një veprimtarie të ndaluar në kuptim të Vendimit Nr. 9 të Komisionit Rregullator, ku promovohen investime për të cilën janë alokuar fonde dy muaj para fushatës. Së treti, ky takim vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore ku drejtuesit kanë promovuar investime me interes publik, në prani të banorëve të zonës dhe në një komunikim me video live nga profili personal i kandidates zonjës Eriselda Sefa. Rrjedhimisht, prezenca e zotit Çako në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm, cilësi që pranohet edhe në shkresën e tij, implikon favorizimin e kandidatit në zgjedhje. Nga pamjet filmike në ligjëratën e palëve është folur dhe promovuar gjatë investimi i bërë në pritën e Lumit Shkumbin. Përsa i përket pretendimit lidhur me raportimin në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga pamjet e raportuara vërehet, prezenca e shtuar e banorëve të zonës pjesëmarrës në këtë aktivitet të cilët nuk ngurrojnë të pozojnë me kandidaten dhe zotin Balla. Gjë të cilën ne i kemi të dokumentuara me fotot që kemi depozituar dhe nga ku provohet se nuk ishte një takim rastësor në këtë zonë, por një takim i mirorganizuar. Në denoncimin tonë i referohemi vetëm fakteve publike dhe kërkimeve të bëra nuk na rezulton të jetë raportuar aktiviteti në fjalë në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në konkluzion për sa më sipër, vërehet qartë nga deklaratimet e bëra nga palët, fondet për këto vepra publike janë alokuar 2 muaj përpara zgjedhjeve vendore duke e bërë promovimin e këtij investimi një veprimtari

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

të ndaluar për t'u promovuar, duke shkelur kështu nenet 91, 92 të Kodit Zgjedhor.
Për sa me sipër, kërkojmë:

Konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenin 171 dhe 172 të Kodit Zgjedhor ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Mbrojtjes Civile zotit Haki Çako, ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë dhe kandidates zonjës Eriselda Sefa.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Dokumentacionin shoqërues, provat lidhur me këtë denoncim i keni depozituar. Kemi një përgjigje më duket Madalena, për këtë nga drejtori, lidhur me këtë? I keni njohur me përgjigjen?

Znj. M. Koja: Po!

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë në se nuk keni gjë tjetër për të shtuar, po e konsiderojmë të përfunduar hetimin administrativ. Përfundimisht, kërkon që të pranohet kërkesa juaj, mirë faleminderit! Atëherë, përfundojmë hetimin administrativ dhe shpalljen e vendimit do ta bëjmë një ditë tjetër, e cila do t'u njoftohet dita dhe ora.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

01.06.2022
Ora 11:16

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zonjës Majlinda Angoni, kandidate për kryetare të Bashkisë Shkodër, zotit Haki Çako, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ:
**Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Të tjerë:**
 1. Qëndresa Qytetare: **Z. R. Xhemollari, znj. Teisa Kurti**
 2. **KRIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit nga Qëndresa Qytetare, ndaj zonjës Majlinda Angoni kandidate për kryetare të Bashkisë Shkodër, zotit Haki Çako, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste. Përfaqësuesit e Qëndresës janë prezent!

Nga pala tjetër nuk kemi prezencë! Atëherë i japim fjalën përfaqësuesit të Qëndresës për të prezantuar pretendimet e tyre në lidhje me këtë denoncim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

Znj. T. Kurti: Faleminderit i nderuar, në denoncimin me nr. 3586 ID, Qëndresa Qytetare ka raportuar aktivitetin e datës 10 Shkurt 2022 në Fshatin Obot, ku është i pranishëm Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, zoti Haki Çako së bashku me kandidaten e Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetare të bashkisë zonja Majlina Angoni. Vlen për t’u theksuar që zonja në fjalë, tre ditë më parë, pra në datën 7 Shkurt, ka deklaruar dorëheqjen e saj nga posti i prefektit të Qarkut Shkodër. Të dy së bashku në datën 10, pra tre ditë më pas nga dorëheqja, kanë vizituar familjen Gocaj duke premtuar përveç ndihmave materiale edhe nisjen e procedurave për ndërtimin e shtëpisë së djegur nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Për këtë rast shihet se është vënë në mbështetje të kandidatës dhe drejtuesi i këtij organi, në një dalje publike që përkon me periudhën e afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme. Periudhë e cila i detyron institucionet publike, të raportojnë aktivitetet me karakter publik që prej datës 31 Janar 2022, duke shkelur kështu vendimin e Komisionit Rregullator. Vlen për t’u përmendur që ky takim është transmetuar edhe në mediat lokale, konkretisht në “TV One-Channel-Shkodër”. Fakt i cili konfirmon edhe karakterin publik të këtij aktiviteti. Gjithashtu në shkelje të nenit 6, pika 3 të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, një zyrtar i lartë siç është zoti Çako, gjatë orarit zyrtar të punës shfaqet pranë kandidatës në zgjedhje, në një veprimtari me karakter publik. Aktivitet ky i cili nuk na rezulton të jetë njoftuar më parë. Në referim të shkresës kthim-përgjigje që zoti Çako ka përcjellë thuhet se “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nuk ishte në dijeni që zonja Angoni kishte dhënë dorëheqjen”, gjë që është e pa justifikueshme dhe nuk përjashton përgjegjësinë që zoti Çako kishte për të mos marrë pjesë në një aktivitet që konkretisht nuk po kryhej me prefektin, por me kandidatin. Në këto kushte, ne besojmë dhe gjykojmë se jemi përpara shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe kërkojmë nga ana juaj, konstatimin e shkeljeve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

dhe marrjen e sanksioneve administrative në bazë të nenit 171, 172 të Kodit Zgjedhor, si dhe nenin 10 të vendimit të Komisionit Rregullator.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Palëve në këtë shqyrtim ju keni bërë me dije? Kanë dërguar pretendime, përgjigje, palës tjetër i janë vënë në dispozicion?

Znj. M. Koja: Po!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit!

Znj. T. Kurti: Është vetëm një shkresë nga ana e agjencisë që thotë që “nuk kemi pas...!”

Z. I. Celibashi: Tjetër nuk kemi?

Znj. M. Koja: Jo!

Z. I. Celibashi: Ndërkohë janë njoftuar për denoncimin e organizatës?

Znj. M. Koja: Po!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Gjë tjetër nuk kemi për shtesë dokumentacioni? Dakord! Atëherë e përfundojmë hetimin administrativ edhe për këtë çështje. Përfundimisht, kërkoni që të pranohet kërkesa për të vendosur sanksion administrativ. Atëherë, përfundojmë hetimin administrativ, shpalljen e vendimit do ta bëjmë një ditë tjetër, e cila do t’ju njoftohet zyrtarisht!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

01.06.2022
Ora 11:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zonjës Majlinda Angoni, kandidate për kryetare të Bashkisë Shkodër, qendrës shëndetësore “Rrethina”. Ambulanca Dobraq, zonja Edona Tafa dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Të tjerë:**
 1. Qëndresa Qytetare: **Z. R. Xhemollari, znj. Teisa Kurti**
 2. **KRIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit po nga Qëndresa Qytetare, ndaj zonjës Majlinda Angoni kandidate për kryetare të Bashkisë Shkodër, nga Partia Socialiste, qendrës shëndetësore “Rrethina”, ambulancës Dobraq, zonja Edona Tafa dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Nuk kemi prezencë nga pala e dononcuar. Përfaqësuesit e Qëndresë janë prezent, fjala për ju!

Znj. T. Kurti: Faleminderit i nderuar! Në denoncimin nr. 3671 ID, Qëndresa Qytetare, ka raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve spotin elektorale të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

kandidates së Partisë Socialiste për kryetare bashkie zonja Majlinda Angoni. Spot i cili është postuar nw faqen zyrtare tw kandidates në datën 2 Mars 2022, pak ditë para zgjedhjeve, ku në imazhet e spotit shihet qartë që janë përdorur asete dhe burime publike. Pasi jemi njohur me deklaratimet e palëve dhe konkretisht me kthim-përgjigjen e zonjës Majlinda Angoni, e cila pranon shprehimisht se konstatimet e bëra në denoncimin e Qëndresa Qytetare, janë të drejta. Në referim të përgjigjes të saj zonja Angoni, shprehet se ka qenë një pakujdesi nga ana e grupit të xhirimit dhe pohon se ky spot është publikuar vetëm një herë, duke lënë të kuptohet se zonja Angoni ka qenë e vetëdijshme se ky spot ishte në shkelje të ligjit. Së dyti, nëse do të analizojmë me vëmendje të gjithë spotin është më se e qartë se kompozimi i spotit nuk ka qenë aspak rastësor, por i mirëmenduar. Për këtë spot është vënë në dispozicion Qendra Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraç, ku nga pamjet shihet se nga personat përgjegjës për administrimin, është dhënë leje të xhirohet fare lehtësisht dhe pa pengesa. Në këto kushte, në referim të nenit 91, i cili parashikon në mënyre eskplcite se “nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike apo të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor”. Në këtë denoncim vihet re., në referim të “burimeve” do të quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, pjesë të qendrës shëndetësore si dhe punonjësit që siç shihet qartë, është vënë në dispozicion të kandidates edhe mjekja e këtij institucioni shëndetësor. Siç shihet nga pamjet merr pjesë në një veprimtari me karakter politik, siç është spoti elektorale i zonjës Angoni. Në këtë spot është mjekja zonja Edona Tafa e cila paraqitet në ambientet e Qendrës Shëndetësore “Rrethina”, e veshur me bluzën e bardhë, nën petkun e mjekut dhe deklaron mbështetjen për kandidaten zonja Angoni duke u shprehur se “... Jam e bindur që një grua multidimensionale si zonja Majlinda Angoni që e ka sprovuar veten në shumë fusha me suksese është zgjedhja e duhur për një bashki të shkodranëve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*


Unë votoj Mjalinda Angonin. ...”. Po ashtu në referim të nenit 6, pika 3 të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, “Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik”. Nga pala thuhet se është e paqartë nëse ka qenë orari zyrtar i punës, por shoh që qendra shëndetësore mban edhe titullin ambulancë, besojmë se orari zyrtar i saj shkon edhe përtej orës 17:00. Këtë jemi në pamundësi për ta vërtetuar. Për sa më sipër, shprehemi se nga konstatimet e bëra nga ana jonë, është pranuar se është përdorur një burim publik siç është qendra shëndetësore “Rrethina”, duke shkelur parashikimet e nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Deklarimet se kompozimi i spotit ka qenë një pakujdesi nuk e justifikojnë përdorimin e aseteve publike dhe shkeljen e ligjit. Përdorimi ose vënia në mbështetje të kandidatëve, subjekteve zgjedhore, e burimeve të organeve apo enteve publike, favorizon këtë të fundit duke dëmtuar procesin demokratik të zgjedhjeve dhe konkurrencën e lirë dhe të pastër. Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj pranimin e kërkesës sonë. Konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar ne nenin 171 dhe 172 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 10 të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, ndaj drejtorit të Qendrës Shëndetësore, ndaj mjekes zonjë Edona Tafa, ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë dhe kandidatës zonja Majlinda Angoni.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Keni pas komunikim me palët e interesuara?

Znj. M. Koja: Po!

Z. I. Celibashi: Kanë prezantuar pretendime, shkresa? Është njohur dhe qëndresa?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.06.2022*

Znj. M. Koja: Po ua kemi dhënë!

Z. I. Celibashi: Dakord! Faleminderit! Shtesa të tjera, dokumentacion? Nuk kemi! Mirë, faleminderit! Atëherë e përfundojmë hetimin administrativ në lidhje me këtë denoncim. Përfundimisht, kërkoni që të pranohet kërkesa dhe të vendosen sanksione administrative për subjektet e denoncuara nga ana juaj. Mirë faleminderit! Atëherë, shpalljen e vendimit do ta bëjmë një ditë tjetër, të cilën do t'jua njoftojmë zyrtarisht. Faleminderit për prezencën, nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës, seanca mbyllet, ditën e mirë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

